Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Drejtësisë

Departamenti Civil

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: E drejtë Familjare

"A duhen të legjitimohen marrëdhëniet konsensuale inçestuoze?"

Punoi: Danjela **JAKAJ**

Master Shkencor Civil, viti i dytë

Tiranë, 2021

Abstract

Hyrja e bërthamës së këtij punimi është koncentruar në studimin e përgjithshëm të konceptit të inçestit si institut social, e mandej zhvillimi i tij është përqëndruar në rregullimin ligjor të sistemit legjislativ të Republikës së Shqipërisë, duke e vijuar më pas edhe me analizën e legjislacionit në juridiksione si Italia, Spanja, Brazili e Portugalia. Një hapësirë e konsiderueshme elaboruese i është kushtuar edhe parashtrimit të qasjeve psikologjike, ekonomiko–sociale, moralo–fetare të nevojës së moslegjitimimit apo jo të marrëdhënieve konsensuale inçestuoze si dhe nuk është harruar trajtesa e çështjes sensitive të njohjes të atësisë të fëmijës së lindur nga një akt inçesti, e cila ngre në dukje boshllëkun evaziv të një rregullimi ligjor préçiz nga legjislacioni civil shqiptar. Ky punim shoqërohet në vazhdimësi me jurisprudencën e zhvilluar të GJEDNJ, duke u evidentuar roli që ka ajo lidhur me shpjegimin zgjerues të institutit të martesës dhe vendosjes prevaluese të interesit më të lartë të fëmijës në marrëdhëniet ndërpesonale ndërmjet subjekteve. Për hartimin e këtij punimi është përdorur literatura online e platformës JSTOR, vendime të GJEDNJ, artikuj elektronikë, burime të tjera interneti.

Fjalët kyçe*: inçest, akt konsensual, legjitimim, rregullim legjislativ*

***

Ku, në fund të fundit, nisin të drejtat universale të njeriut? Në hapësira të vogla,brenda shtëpisë–aq brenda dhe aq të vogla sa që nuk mund të shihen në asnjë hartë të botës[1]*……*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut garanton dhe mbron në mënyrë eksplicite të drejtën për të lidhur martesë dhe për të krijuar familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte[2]. Në mënyrë analoge, edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e sanksionon këtë të drejtë kushtetuese në nenin respektiv të saj[3], duke i ofruar çdo shtetasi shqiptar një mbrojtje të veçantë të lirisë së tij legjitime për të lidhur martesë apo për të krijuar familje. Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nocioni i martesës në drejtimin moral, ekonomiko–social dhe juridik është një koncept autonom dhe nuk mund të konkludohet në një definicion

[1] Eleanor Roosevelt, U.S.A, 1958
[2] Neni 12 i KEDNJ
[3] Neni 53 i Kushtetutës

préciz të përbashkët për të gjitha shtetet anëtare[4]. Meqënëse martesa si institut prodhon pasoja diverse të karakterit personal, social e ligjor, por edhe rëndësia që ajo mbart në ndërtimin e një mjedisi familjar që duhet të synojë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës, Gjykata, në jurisprudencën e saj të zhvilluar, arsyeton në linjë logjike se nuk mund të njësojë kritere taksative unifikuese që duhet të përmbushë një bashkëjetesë e vlefshme ligjore[5], por në gjykimin e saj solid këtë hallkë vlerësuese duhet ta ushtrojnë autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të cilat arrijnë të marrin vesh më shpejt dhe të kanalizojnë më objektivisht nevojat e shoqërisë.

E drejta për të lidhur martesë nuk është absolute. Krahas kushteve pozitive që favorizojnë lidhjen juridike të saj, ligjet kombëtare e më specifikisht Kodi i Familjes të Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht ndalesat ligjore – kushtet negative – ato fakte juridike, ekzistenca e të cilave pengojnë dhe refuzojnë konsentin e subjekteve për tu lidhur juridikisht në martesë. Më konkrete, disa nga dispozitat sanksionuese që përkojnë me kufizimin imperativ të përmendur, lidhen me shkallët e afinitetit[6] apo siç konceptohet ndryshe me termin shoqëror të marrëdhënieve inçestuoze brenda farefisnisë. Duhet thënë se, nocioni i inçestit nuk përkufizohet në terma ligjorë në asnjë kuadër civil apo penal shqiptar, por zbërthimi etimologjik e specifikon atë si marrëdhënia seksuale në mes dy personave të cilët janë në lidhje të ngushtë gjaku deri në 4 breza[7]. Një definicion tjetër i konceptit të inçestit që merret nga fjalori i Webster's 1828[8] e përcepton fjalën si krim brenda bashkëjetesës midis personave të të njëjtës gjini, martesa ndërmjet të cilëve ndalohet me ligj. Duke i dhënë rëndësinë prevaluese r*atio legis*, por duke marrë në konsideratë edhe opinione të studiuesve prominent, është konkluduar se përligja e ndalimit të lidhjes juridike mes personave brenda shkallëve të gjakut lidhet thelbësisht me motivet eugjenike nga njëra anë, por edhe me motivet morale a sociale nga ana tjetër, të cilat do të kenë hapësirën elaboruese në paragrafët në vijim, por duhet përmendur gjithashtu fakti se ekzistojnë edhe shtjellime të natyrës shkencore dhe juridike, të ndërlidhura me çështje sensitive, që e kundërshtojnë në rrënjë qasjen aktuale ligjore.

---

[4] https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_12_ENG.pdf, aksesuar më 10 Tetor,2021
[5] Çështja B. AND L. v. THE UNITED KINGDOM, no 36536/02, § 36 (2005)
[6] Nenet 10 –14 të Kodit të Familjes
[7] https://sq.wikipedia.org/wiki/Incesti, aksesuar më 10 tetor 2021
[8] K. WEINBIRG (1995), The study of incest behavior, faqe 3 https://www.jstor.org/stable/23286362?seq=21 e aksesuar me 1 Tetor 2021

Gjurmë të hershme të marrëdhënieve inçestuoze apo ndryshe "të zënët e mëkatshëm"[9], misionari anglez Lorimer Faison[10] i konstatoi në rajonin Maunt–Gambir të Australisë Jugore[11], ku fiset barbare ishin ndarë në dy klasa të mëdha ekzogame, kroki dhe kumite. Aktiviteti seksual brenda secilës nga këto klasa ishte e ndaluar rreptësisht, por duhet theksuar se as mosha dhe as aëria gjinore nuk u bënë kurrë pengesë për të kufizuar "fëlligështinë" në gjak, duke lënë kështu mundësinë e shtimit të brezave brenda të të njëjtit lloj. Paskëtaj, me lindjen dhe zhvillimin e familjes punaluane[12], u formësua institucioni i gjinisë që zbehu në të gjitha format e saj familjen e një gjaku dhe zhduku dalëngadalë format primitive të martesës ndërmjet anëtarëve brenda bërthamës familjare[13]. Më vonë u iniciua edhe kategorizimi ligjor i marrëdhënieve të parregullta inçestuoze, proçes që e pati zanafillën në ligjet fetare, ku e drejta kanonike e kishës së Romës përcaktoi në mënyrë eksplicite marrëdhëniet në bashkësi, brenda të cilës martesa ishte e ndaluar. Fillimisht, lista e ndaluar e marrëdhënieve brenda farefisit shtrihej në çdo shkallë në vijë të drejtë dhe të tërthortë[14], por meqënëse kjo pengesë në marrëdhëniet në bashkësi doli të ishte e pazbatueshme, ajo u zëvendësua me një ligj kanonik që ndalonte martesat midis subjekteve që lidheshin me farefisninë deri në shkallën e katërt[15]. Në Republikën e Shqipërisë, sanksionimi ligjor për herë të parë i institutit të inçestit gjendet në Kanunin e Lek Dukagjinit, e formalizuar në tre dispozita ku thuhej se vargu i brezave të gjakut të gjinisë shkonte në të "pasosun" për shqiptarët e malëve[16].

Sot, nocioni i marrëdhënieve inçestuoze përcjell në përceptimin e opinionit publik ndjenja të forta kundërshtuese dhe neverie, në përgjithësi kjo si pasojë e konfuzionit të gabuar të konceptit të inçestit me veprën penale të abuzimit seksual të fëmijëve, duke sjellë kështu përjashtimin në plotësi të mendimit objektiv të lejueshmërisë të formës së veçantë të martesës ndërmjet anëtarëve brenda gjinisë. Pavarësisht ekzistencës së faktit dhe qasjes kundërshtuese dhe vlerësuese të

---

[9] **Shënim**: Bahofeni këto marrëdhënie i etiketonte më termin "Sumpfzeugung" ose ndryshe të paligjshme. Në qoftë se Bahofeni i quan këto martesa të panatyrshme, njeriu i asaj epoke do ta quante shumicën e martesave të sotme midis kushërinjve të afërm apo të largët, nga ana e atit ose e nënës, si një fëlligshti në gjak.

[10] **Shënim**: Lorimer Faison (9 Nëntor 1832– 29 Dhjetor 1907) ishte antropolog Australian që studioi format e zhvillimit të familjes ndër vite

[11] ENGELS, F. (1970).Origjina e familjes e pronës private dhe e shtetit, fq 62

[12] **Shënim**: Forma e parë e familjes që karakterizohej nga shkallët e aferisë

[13] **Shënim**: Nuk u përjashtua martesa ndërmjet fëmijëve të motrës dhe vëllait

[14] Carmichael, C. (1995). Incest in the Bible, fq 10

[15] Ultimate Taboos: Incest and Mormon Polygamy, fq 96 https://www.jstor.org/stable/23286362?seq=21 e akssesuar me 1 Tetor 2021

[16] https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf, aksesuar më 12 Tetor 2021/ Nenet 695–697

inçestit si dekonstruksion të shoqërisë, saksionimet ligjore, përsa i përket refuzimit të lidhjeve brenda farefisnisë, por edhe kategorizimet e këtyre të fundit, ndryshojnë nga njëra kulturë në tjetrën. Në kuadrin ligjor familjar të Republikës së Shqipërisë, specifikisht në nenin 10 të saj, parashikohet se nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji e mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave[17]. Sikurse konstatohet nga kjo dispozitë, ndërsa lidhja e gjakut në vijë të drejtë përbën pengesë për lidhjen e martesës pavarësisht nga shkalla e afërsisë së personave në gjini, lidhja e gjakut në vijë të tërthortë përbën pengesë për lidhje martese si rregull, deri në shkallën e katërt[18]. Ligji vijon më tej duke konsideruar si pengesë të përhershme për lidhjen e martesës edhe lidhjen familjare që bazohet në marrëdhënien e birësimit[19] apo atë të krushqisë[20]. Në këtë kontekst, kujtojmë se ligjvënësi jo vetëm që pengon lidhjen e martesës ndërmjet këtyre personave, por ndalon e ndëshkon edhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet disa prej këtyre subjekteve, duke i materializuar ato në veprën penale të marrëdhënieve seksuale me persona në gjini[21]. Të njëjtën parashikim ligjor ndëshkues ka edhe shteti Italian, ku marrëdhëniet inçestuoze konsiderohen krim nëse provokojnë skandal publik[22], por nga ana tjetër kemi edhe shtete si Mbretëria e Spanjës, ku inçesti jo vetëm që nuk është i kriminalizuar në asnjë dispozitë penale, por lidhja juridike ndërmjet anëtarëve është e ndaluar deri në shkallën e tretë të gjakut në vijë të tërthortë[23]. Duke vazhduar, në Portugali, lidhja juridike ka pavlefshmëri *ab initio* dhe nuk prodhon pasoja ligjore kur është e solemnizuar ndërmjet anëtarëve deri në shkallën e dytë të gjinisë në vijë të tërthortë[24], ndërsa në Brazil, marrëdhënia seksuale ndërmjet dy të miturve të të njëjtit gjak nuk ndëshkohet penalisht, por ndëmjet anëtarëve që kanë diferencë të madhe moshe është kategorikisht e ndaluar[25] deri në shkallën e katërt në vijë të tërthortë. Siç konstatohet, në shumicën e vendeve evropiane, marrëdhënia seksuale që lind dhe ndërtohet mes anëtarëve të të njëjtës bashkësi, nuk është e predispozuar të ndëshkohet nëse mes tyre ka një vullnet të lirë, por në asnjërën prej tyre

---

[17] **Shënim**: Nuk ka ndonjë rast praktik në Shqipëri, por vlerësohet nga doktrina se "shkak me rëndësi" do të vërtetohet nga personat që kërkojnë autorizimin për martesë dhe do të analizohet nën diskrecionin e gjykatës, rast pas rasti

[18] Omari, S. (2012). E drejta familjare, fq 63

[19] Neni 14 i Kodit të Familjes të RSH

[20] Neni 11 i Kodit të Familjes të RSH

[21] Neni 106 i Kodit Penal të RSH

[22] Neni 564 i Kodit Penal Italian/ Kjo vepër dënohet nga 1 deri në 5 vite dhe nocioni i skandalit publik interpretohet rast pas rasti nga gjykata https://www.imolin.org/doc/amlid/Italy/penal_code.pdf aksesuar më 13 Tetor 2021

[23]Neni 47 i Kodit Civil të Spanjës https://www.icj.org/wp-content/uploads/2013/05/Spain-Spanish-Civil-Code-2012-eng.pdf aksesuar më 12 Tetor 2021

[24] Neni 1075 i Kodit Civil të Portugalisë/ lejohet martesa mes emtës dhe nipit; xhaxhait dhe mbesës https://www.indiacode.nic.in/bitstream/123456789/8312/1/ocrportuguesecivilcode.pdf aksesuar më 12 Tetor 2021

[25] Neni 1521 i Kodit Civil të Brazilit https://wipolex.wipo.int/en/text/226199 aksesuar më 14 Tetor 2021

ligja nuk lejon formalizim në lidhje të vlefshme juridike pa kufizimet specifike, të cilat përligja e këtyre të fundit ndjek dhe përfshin brenda suazës së saj motivet me natyrë shkencore, ekonomiko–sociale dhe moralo–fetare.

E evidentuar mësipër, një nga arsyet esenciale, që strukturat ligjvënëse shtetërore mbajnë një qëndrim statik mohues ndaj rregullimit ligjor të marrëdhënieve inçestuoze[26], lidhet drejtpërsëdrejti me funksionin trashëgues biologjik të këtij ndërveprimi personal, në të cilin shteti ka një interes të ngushtë legjitim. Diversiteti gjenetik dhe kontrolli i mekanizmave shtetërorë të "kanalizimit" gjenetik nëpërmjet instituteve juridike, përkon me *ratio legis* se pasardhësit që lindin nga një marrëdhënie inçestuoze konceptohen si barrë sociale dhe ekonomike[27], si pasoja të një mutacioni gjenetik, që në të shumtën e rasteve arrin të kufizojë ndjeshëm aftësinë intelektuale të individit për të kuptuar karakterin e marrëdhënieve diverse juridiko–sociale. Pikërisht, kjo llogjikë juridike e ndërlidhur me shkencat e tjera, që inkuadron ndalimin e konvertimit të çiftëzimeve në bashkësi në lidhje ligjore të vlefshme, së paku brenda katër brezave, lidhet me besimin relativ, të përciptë dhe shpesh herë edhe jo shkencërisht të shqyrtuar se lidhjet ndërpersonale në bashkësi, sjellin në çdo rast në jetë pasardhës me mutacione gjenetike. Ekzaminimi i ligjeve të Mendelit[28], e më specifikisht trashëgimia autosomike dhe seksuale, zbulon në baza shkencore se ky konkludim kritik i mbështetur, është thjesht i pasaktë dhe nuk i përkon të vërtetës reale. Është e vërtetë që marrëdhëniet inçestuoze mund të rrisin gjasat për shfaqjen e tipareve të dëmshme të gjenit reçesiv[29] në brezat e ardhshëm, kjo e mbështetur edhe nga disa të dhëna empirike të marra nga situata konkrete, të cilat tregojnë se çiftëzimet në bashkësi kanë çuar në rritjen e shkallës së vdekshmërisë foshnjore, defekte të lindura apo ndryshime antropometrike[30], por duhet të kihet parasysh se shkenca e gjenetikës ka arritur të parashikojë dhe llogarisë kur individët janë mbartës të tipareve të dëmshme të gjenit reçesiv si dhe të vlerësojë edhe rreziqet që mund të shfaqen te një pasardhës që planifikohet të vijë nga një marrëdhënie me individë mbartës të gjeneve të tilla[31]. Për më tepër, jo të gjitha

---

[26] Përjashtimisht, Neni 10 i Kodit të Familjes sanksionin diskrecionin e Gjykatës që të lejojë martesën midis fëmijëve të vëllezërve dhe të motrave, për shkaqe me rëndësi.

[27] Kasemset, C. (2009). Should Consensual Incest Between Consanguine Adults Be Restricted?, fq 84 file:///C:/Users/user/Downloads/mchang-journal-manager-kasemset-lo-v2.pdf e akseseuar më 27 Tetor 2021

[28] Për më tepër hollësi rreth shpjegimit gjenetik të kromozomeve të trashëguara ndërmjet subjekteve të të njëjtit farefis shikoni artikullin elektronik: "Incest statutes and the fundamental right of marriage: Is Oedipus free to marry?, fq 267-274 https://www.jstor.org/stable/25739374?seq=13, aksesuar më 3 Tetor 2021

[29] **Shënim**: Një gjen reçesiv është përgjegjës për përcaktimin e karakteristikave "reçesive" të fenotipit të individëve

[30] https://pediatrics.aappublications.org/content/40/1/55?download=true, aksesuar më 3 Tetor 2021

[31] Cit, "Incest statutes and the fundamental right of marriage: Is Oedipus free to marry?, fq 276

qëndrimet ligjore rreth ndalimit të martesave inçestuoze mund të kenë si analizë të qëndrueshme mutacionin gjenetik, sepse çiftëzime si vjehërr – nuse nuk kanë aspak implikime të dëmshme gjenetike.

Duke vazhduar, në panoramën psikologjike, ndërsa raportet jo konsensuale inçestuoze, kryesisht ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve, mund të prodhojnë varësi seksuale, probleme të shëndetit mendor, distancim emocional, konfuzion apo çrregullim të aftësisë për tu përfshirë emocionalisht dhe fizikisht në një marrëdhënie[32], psikologët nuk kanë arsyetur me të njëjtën përfundim për aktin konsensual të inçestit[33]. Shkenca e psikologjisë pranon se gjasat janë të pakta për të mos thënë të pakonsiderueshme që subjektet e një gjaku, të zotë për të vepruar e me konsensusin e tyre të lirë për tu përfshirë në marrëdhënie ndërpersonale, të provojnë simptoma të rënda psikologjike apo fizike[34]. Linja logjike që formon dhe ndjek këtë konkludim lidhet esencialisht me vullnetin e lirë të palëve, marrëdhënia e të cilëve karakterizohet nga reciprociteti dhe zgjedhje të lira konstruktive ndërmjet tyre.

Krahas shpjegimeve shkencore–gjenetike dhe ato psikologjike, parimet fetare si dhe përkufizimet relative të nocioneve të moralit publik, e veshin inçestin me imoralitet dhe e konsiderojnë atë jashtë një marrëdhënie "normale", duke justifikuar kështu përdorimin ndalues të ligjeve imperative laike për të vënë në zbatim praktik tabunë e inçestit konsensual. Libri i shenjtë i Biblës, në frymën e saj përcakton se cilat konsiderohen marrëdhënie inçestuoze, duke ndaluar moralisht intimitetin fizik ndërmjet babit–vajzës, nënës– djalit, gjyshit– mbesës, e shumë ndarje të tjera[35]. Krahas kësaj edhe ligji islam Kurani[36] e përmend në rreshtat e tij se është hyjnisht e ndaluar marrëdhënia ndërmjet të njëjtit gjak, e nëse ndodh kjo me konsent, interaktiviteti fizik konsiderohet i pafalshëm e imoral. Gjatë leximit të esencës, por edhe kuptimit të parashikimit të njëllojtë fetar rreth institutit të inçestit, arrihet konkludimi se mospranimi i "bekimit" të marrëdhënieve inçestuoze konsensuale në martesë lidhet me karakterin "e panatyrshëm" të vetë aktit. Kjo, sipas ligjit fetar, do të thotë se, akti inçestual nuk i shërben dhe nuk është në përputhje me natyrën njerëzore, duke ndikuar dhe kontribuar negativisht në mbarëvajtjen e mirëqenies shëndetësore fizike apo psikologjike të ripërtëritjes së shoqërisë.

---

[32] https://www.rightstep.com/rehab-blog/psychological-effects-covert-incest e aksesuar më 14 Tetor 2021
[33] https://www.goodtherapy.org/blog/psychpedia/incest e aksesuar më 14 Tetor 2021
[34] Hornle, T.(2014). Consensual adult incest: A sex offense? fq 93
https://www.jstor.org/stable/10.1525/nclr.2014.17.1.76?seq=27 e aksesuar më 28 Tetor 2021
[35] Leviticus 18:7–18 https://bible.com/bible/8/1jn.5.3.AMPC e aksesuar më 8 Tetor 2021
[36] Ajeti 35:50 i Kuranit

Një çështje sensitive për analizim në këtë kuadër, e cila ka patur edhe fokus specifik legjislativ në disa shtete të ndryshme, ka qenë pikërisht njohja e atësisë të fëmijëve të lindur nga një marrëdhënie inçesti, ku disa legjislacione mbajnë qëndrim mohues ndaj tij. Konkretisht, në legjislacionin Francez[37] apo atë Hollandez[38], edhe pse akti konsensual i inçestit nuk ndëshkohet penalisht, njohja e atësisë së një fëmije që ka lindur si rrjedhojë e saj nuk lejohet të ketë në prevalencë të vërtetën biologjike, me arsyetimin se kjo e fundit mund të shkaktojë dëm serioz në shëndetin psikologjik të fëmijës. Nga ana tjetër, legjislacioni civil Italian deri para vitit 2012[39] e ndalonte njohjen e atësisë të fëmijëve të lindur nga një marrëdhënie inçesti, nëse prindërit e tij në momentin e konceptimit kanë qënë në dijeni të marrëdhënies gjinore, por më vonë, vendimi i rëndësishëm i Gjykatës Kushtetuese Italiane n.50/2006[40], solli një ndryshim substancial, e cila hodhi dritë mbi të drejtën e fëmijëve për të patur një identitet të përcaktuar, duke i dhënë kësaj të fundit konsideratë parësore edhe në rastin e inçestit. Në ligjin shqiptar, lidhur me këtë sensitivitet, nuk kemi një rregullim specifik apo ndonjë praktikë konkrete gjyqësore, e cila dukshëm ngre problematikën e mbrojtjes ligjore të interesit më të lartë të fëmijës si dhe sigurimin e identitetit të plotë të tij. Pavarësisht se, mungesa e ekzistencës së një parashikimi të tillë ligjor përbën vakum për legjislacionin tonë, GJEDNJ, në korpusin e saj brilant, shprehet në lidhje me këtë ngërç duke reflektuar drejtpërsëdrejti detyrimin e prerë për shtetet anëtare në gjetjen e një balance të artë mes "të vërtetës biologjike" dhe "origjinës sociale"[41], në zgjidhjen dhe materializimin e këtyre të fundit në sistemin e brendshëm ligjor.

KONKLUZIONE dhe REKOMANDIME

Duke sintetizuar të gjithë rrjedhshmërinë logjike të zhvillimit të institutit social të inçestit, ndërlidhur kjo edhe me "shqetësimet" shkencorë, ekonomiko–socialë dhe moralo–fetar rreth hipotezës legjitimuese të marrëdhënieve konsensuale inçestuoze, arrihet në fundin se moslejimi i lidhjes juridike mes subjekteve brenda të të njëjtës gjini nuk ka funksion të plotë mbrojtës në ruajtjen e gjirit familjar dhe parandalues të efekteve shkatërruese që gabimisht prezumohen se sjell raporti seksual ndërmjet tyre. Interesat e rëndësishëm të shtetit për të siguruar një "përqafim" protektiv të interesit publik nëpërmjet ndalimit të aktit konsensual të inçestit si

[37]Neni 310-2 i Kodit Civil Francez
[38] Nenet 1:41 dhe 1:204 (1) të Kodit Civil Holandez.
[39] Mosco L.(1977). Filiazione legittima e naturale, in Il diritto di famiglia, Cacucci, Bari, f. 265.
[40] Vendim i Gjykatës Italiane të Kasacionit, Sesioni i parë, nr. 4/2008 i datës 3 janar 2008.
[41] Fana. M.(2016). Trajtime teorike mbi njohjen dhe kundërshtimin e atësisë, fq 72

nevojshmëri për mbrojtjen e familjes, por edhe të interesit më të lartë të fëmijës, mund të konsiderohen të pranueshme intuitivisht, por në thelb nuk i rezistojnë analizës.

Së pari, motivet eugjenike që përbëjnë justifikimin kryesor të ndalimit të marrëdhënieve brenda gjinisë, nuk janë racionale sepse shkencërisht është vërtetuar që mund të arrihet ndalimi i riprodhimit nga subjekte që mbartin gjenet e dëmshme reçesive, pa qenë e nevojshme pengesa e përhershme e një lidhje juridike. Për më tepër, siç u evidentua çiftëzime si vjehërr–nuse nuk kanë aspak implikime të dëmshme gjenetike, duke e bërë kështu dispozitën një nonsens juridik.

Së dyti, moslejimi ligjor i aktit konsensual të inçestit si mekanizëm i përshtatshëm për të mbrojtur fëmijët nga format diverse të abuzimit seksual, është i tepërt në këtë kontekst sepse kuadri ligjor penal ka parashikuar dispozitat konkrete që ofrojnë mbrojtje më efikase e gjithëpërfshirëse në parandalimin e ekzistencës së këtij fenomeni negativ. Etiketimi i gabuar i raportit konsensual inçestuoz si abuzim seksual apo sjellje degraduese imorale, kjo si pasojë e mungesës së një përkufizimi uniform ligjor të nocionit të inçestit, nuk vlen në këtë analizë nëse mes subjekteve shprehet një vullnet i plotë, i qartë dhe i pavesuar në qëllimin e ndërtimit të një bashkëjetese të vlefshme ligjore.

Së treti, është shumë e rëndësishme të evidentohet që moslegjitimi ndërhyn dhe cënon të drejtën e subjekteve për të lidhur martesë, duke ndikuar kjo drejtpërsëdrejti edhe në lejimin e përcaktimit ligjor të identitetit të plotë të fëmijëve që mund të vijnë si pasojë e saj. Kjo çështje sensitive nuk ka një rregullim ligjor konkret në kuadrin legjislativ të Republikës së Shqipërisë, por në vende të ndryshme evropiane ndiqen qasje të ndryshme rregulluese, duke afektuar kështu mirë-integrimin e fëmijës në familje dhe në shoqëri.

Në analizë të gjithë sa më sipër, është e rëndësishme të identifikohen disa rekomandime për trajtimin që i bëhet konceptit të inçestit në Shqipëri.

Sikurse është parashtruar edhe në këtë punim, motivet eugjenike, psikologjike apo ato morale nuk përbëjnë baza të forta arsyetimi për parandalimin ligjor të lidhjes juridike brenda gjinisë. Në këtë kontekst, gjejmë vendin të theksjomë se *de lege ferenda* dispozitat e kodit të familjes duhet të parashikojnë mundësinë e autorizimit nga gjykata të martesës ndërmjet personave në lidhje krushqie, birësimi apo të vlerësojë vullnetin e lirë të subjekteve në lidhje gjaku për tu lidhur në martesë. Nëse nuk ka pengesa ligjore rreth çiftëzimit të subjekteve që mund të sjellin në jetë një

pasardhës me probleme gjenetike, atëherë as martesat inçestuoze nuk duhet të ndalohen mbi baza të tilla.

Një propozim tjetër i referohet pikërisht nevojës për të thelluar diskutimet teorike mbi institutin e inçestit, veçanërisht ato të dimensionit krahasues me vendet e tjera, si dhe nevojës për të pasuruar praktikën gjyqësore me trajtime të rasteve të tilla. Edhe pse aktualisht në Shqipëri konsiderohen tabu marrëdhëniet konsensuale inçestuoze, është domosdoshmëri që legjislacioni dhe praktika gjyqësore të përshtaten e të reflektojnë ndryshimet e perceptimit jo tradicional të konceptit të bashkëjetesës së vlefshme ligjore.

Së fundmi, rastet e njohjes të atësisë të fëmijëve të lindur si pasojë e një marrëdhënie inçestuoze, duhet të trajtohen në ligj nga pikëpamja përmbajtësore, duke marrë në konsideratë prevaluese interesin më të lartë të fëmijës, e cila duhet të përmbajë balancimin e “të vërtetës biologjike” dhe “origjinën sociale”.

BIBLIOGRAFIA

ARTIKUJ ELEKTRONIKË NGA JSTOR

Hornle, T. (2014). Consensual adult incest: A sex offense?, 17(1), 76-10. Retrieved October 28, 2021, from https://www.jstor.org/stable/10.1525/nclr.2014.17.1.76?seq=27

Pocar, V. & Ronfani, P. (1978). Family law in Italy: Legislative innovations and social change, 12(4), 607-644. Retrieved October 23, 2021, from https://www.jstor.org/stable/3053307?readnow=1&refreqid=excelsior%3Af1effe82a603b3c92aa7c0d1c061a437&seq=1#page_scan_tab_contents

Bratt, C. (1984). Incest statues and the fundamental right of marriage: Is Oedipus free to marry? 18(3), 257-309. Retrieved October 3, 2021, from https://www.jstor.org/stable/25739374?seq=1

Embry, J. (1992). Ultimate Taboos: Incest and Mormon Polygamy, 18(1), 93-113. Retrieved October 1, 2021, from https://www.jstor.org/stable/23286362?seq=3#metadata_info_tab_contents

Sarfatti, M. (1941). The new Italian Code, 23(1), 18-26. Retrieved October 10, 2021, from https://www.jstor.org/stable/754923

Berest, J. (1968). Medico–Legal Aspects of Incest, 4 (3), 195-205. Retrieved October, 4, 2021, from https://www.jstor.org/stable/3811831

Julliot, L. (1948). The reform of the French Civil Code, 97(1), 1-21. Retrieved October, 4, 2021, from https://www.jstor.org/stable/3309648

Otovo, O. (2015). Marrying "Well": Debating Consanguinity Matrimonial Law, and Brazilian Legal Medicine, 33(3), 703-743. Retrieved October 8, 2021, from https://www.jstor.org/stable/43670801?readnow=1&refreqid=excelsior%3A344d861c0863299e132e668396f764ef&seq=1#page_scan_tab_contents

Lasok, D. (1961). Legitimation, Recognition and Affiliation Proceedings (A study in Comparative Law and Legal Reform, 10(1), 123-142. Retrieved October, 8, 2021, from https://www.jstor.org/stable/756470?readnow=1&refreqid=excelsior%3A6bd6aa49e7b5291489f0de40b14e50c1&seq=1#page_scan_tab_contents

Haliburn, J. (2017). Mother-child incest, psychosis, and the dynamics of relatedness, 18(3), 409-423. Retrieved October 13, 2021, from https://www.jstor.ncbi.nlm.nih.gov/28300493/

Gordon, L. (1986). Incest and Resistance: Patterns of Father Daughter Incest, 1880-1930, 33(4), 253-267. Retrieved October 11, 2021, from https://www.jstor.org/stable/800718?seq=10

Bouchard, C. (1981). Consanguinity and Noble Marriages in the Tenth and Eleventh Centuries, 56(2), 268-287. Retrieved October 23, 2021, from https://www.jstor.org/stable/2846935

WEINBIRG, K. (1995). The study of incest behavior, 8(2), 22-63. Retrieved October 1, 2021, from https://www.jstor.org/stable/23286362?seq=21

ARTIKUJ TË TJERË

Kasemset, C. (2009). Should Consensual Incest Between Consanguine Adults Be Restricted? 2(1), 84-89. Retrieved October 28, 2021, from file:///C:/Users/user/Downloads/mchang-journal-manager-kasemset-lo-v2.pdf

Artikull: Incest avoidance and prohibition: psychobiological and cultural factors, 28(2), 289-297. Retrieved October 27, 2021, from https://www.scielo.br/j/pusp/a/MjgNcRJhbDQgqqyCcyxKnYR/?format=pdf&lang=en

Artikull: Psychological Effects of Covert Incest, 3(11), 51-58. Retrieved October 14, 2021, from https://www.rightstep.com/rehab-blog/psychological-effects-covert-incest

Artikull: Children of Incest, 40 (1), 55-62. Retrieved October 3, 2021, from https://pediatrics.aappublications.org/content/40/1/55

Artikull: Incest, retrieved October 14, 2021, from https://www.goodtherapy.org/blog/psychpedia/incest

Kanuni i Lekw Dukagjinit, retrieved October 12, 2021, from https://gruppostudentescoalbanesemilosao.files.wordpress.com/2014/12/kanuni_i_leke_dukagjinit.pdf,

Guide on Article 12 of the European Convention on Human Rights, retrieved October 10, 2021, from https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_12_ENG.pdf

https://sq.wikipedia.org/wiki/Incesti, retrieved October 10, 2021

https://psychology.wikia.org/wiki/Incest, retrieved October 22, 2021

LIBRA

Mosco, L. (1977). Filiazione legittima e naturale, in Il diritto di famiglia, Cacucci, Bari.

Fana, M. (2016). Trajtime teorike mbi njohjen dhe kundërshtimin e atësisë

Omari, S. (2012). E drejta familjare

ENGELS, F. (1970).Origjina e familjes e pronës private dhe e shtetit

Carmichael, C. (1995). Incest in the Bible

KODE dhe KONVENTA

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi i Familjes të Republikës së Shqipërisë

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Kodi Civil i Italisë

Kodi Penal i Italisë

Kodi Civil i Spanjës

Kodi Civil i Brazilit

Kodi Civil i Francës

Kodi Civil i Portugalisë

Kodi Civil i Holandës

Kurani

Bibla

VENDIME GJYQËSORE

Vendim i Gjykatës Italiane të Kasacionit, Sesioni i parë, nr. 4/2008 i datës 3 janar 2008

Vendimi i GJEDNJ, B. AND L. v. THE UNITED KINGDOM, no 36536/02, 2005